



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 61005-00233-00-2021 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2021-323 i Vendimit**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Illir PANDA	Kryesues
Albana BOKSI	Anëtar
Klodian KURUSHI	Anëtar

sot, në datë 18.05.2021, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim prokuroria e posaçme).

PERSONI NËN HETIM: Mimoza Margjeka

E dyshuar: Për veprën penale “Korrupsion i pasiv i gjyqtarit, prokurorit, dhe funksionareve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkepunim, parashikuar nga neni 319/ç -25 të Kodit Penal.

OBJEKTI: Për marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit të të arrestuarve.

BAZA LIGJORE: Nenet 248/1, 246/6, 249 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP).

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjo i relatimin e gjyqtarit Albana Boksi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim gjykata e posaçme), mbi kërkesën e prokurorisë së posaçme, me vendimin nr. 92, datë 5.9.2020, ndër të tjera, ka caktuar masën e sigurimit “arrest në shtëpi” për personin nën hetim Mimoza Margjeka, si e dyshuar për veprën penale “Korrupsion i pasiv i gjyqtarit, prokurorit, dhe funksionareve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319/ç e 25 të Kodit Penal.

1.1. Në datë 09.09.2020 është ekzekutuar vendimi nr. 92, datë 05.09.2020 i gjykatës së posaçme, ndërmjet të tjerëve edhe për personin nën hetim Mimoza Margjeka.

1.2. Në datë 12.09.2020, në zbatim të nenit 248/1 të KPP, gjykata e posaçme ka proceduar me marrjen në pyetje të të arrestuarve përkatës.

1.3. Në datë 12.11.2020, në zbatim të nenit 246/6, të KPP, prokurorja e çështjes ka informuar me shkrim gjykatën (gjyqtaren e hetimit paraprak) mbi hetimet e kryera për procedimin penal nr. 186/2020, si dhe për nevojat e sigurimit në raport me të gjithë të dyshuarit, duke kërkuar vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për personin nën hetim Mimoza Margjeka, duke vlerësuar se vijojnë të ekzistojnë të njëjtat kushte dhe kritere mbi të cilat është caktuar masa e sigurimit.

2. Gjykata Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 403, datë 24.11.2020, (ndër të tjera) ka vendosur:

“Zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, për të hetuarën Mimoza Margjeka me atë “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, duke urdhëruar të hetuarën të paraqitet në policinë gjyqësore pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të hënën e parë të çdo muaji, ora 10:00.”

2.1. Gjykata e posaçme ka argumentuar se: *“... të dhënat e përfutuara nga provat dhe aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në këtë moment nuk kanë ndikuar në lehtësimin e pozitës të të hetuarve, megjithë pretendimet e mbrojtësve të tyre. (...)*

Mbi bazën e analizës së përmbajtjes së akteve dhe provave shkresore të paraqitura, që vjen pas verifikimit të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, pas kalimit të afatit 2-mujor nga zbatimi i masës, gjykata në mbështetje të nenit 228/1 të KPP, vlerëson se dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç e 25 të KP nga të hetuarit M.Margjeka dhe Arben Cara, mbetet i bazuar në prova, pa u zbehur nga momenti i parë i vlerësimit të tij nga ana e gjykatës. Kjo gjykatë e ka detajuar vendimmarrjen e saj të datës 05.09.2020, “dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova për këta të hetuar. Bazuar në parashikimin e nenit 229 të KPP gjykata vlerëson se për të hetuarën M. Margjeka janë zbutur nevojat e sigurimit, duke mos qenë të njëjta me momentin e caktimit të masës së sigurimit dhe me atë të marrjes në pyetje, pas kalimit të afatit tre-ditor. Kjo pasi, mban në konsiderate vendimmarrjen e KLGj datë 14.09.2020, që ka pezulluar nga detyra të hetuarën dhe nevojat jetike të fëmijës së saj të mitur, të cilat çënohen për shkak të ngjarjes penale që ka përfshirë të dy prindërit e saj, Cara dhe Margjeka. (...) Duke qenë se masa e sigurimit “arrest në shtëpi” pengon të hetuarën të plotësojë nevojat jetike të fëmijës së saj, të cilat është në pamundësi të plotësojë prindi tjetër, çmohet lehtësimi i masës ndaj saj në funksion të mos cenimit të të drejtave të fëmijës dhe as të veprimtarisë hetimore të akuzës”.

3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 221, datë 17.12.2020, (ndër të tjera) ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. 403, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për personin nën hetim Mimoza Margjeka, duke vijuar si masë sigurimi ajo e “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i KPP, caktuar me vendimin nr. 92, datë 05.09.2020 të asaj gjykate.”.

3.1. Gjykata e posaçme e apelit arsyeton: *“... gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt provat dhe kërkesat e ligjit duke zëvendësuar masën e sigurimit të caktuar ndaj të hetuarës Mimoza Margjeka. Tërësia e provave të marra, të verifikuara gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, ky koleg vlerëson se, shkaqet e ngritura në ankim nga ana e prokurorit, kundër vendimit nr. 403, datë 24.11.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për ndryshimin e vendimit, janë të bazuara prandaj vendimi duhet të ndryshohet për këtë pjesë, për sa është ankimuar.*

Ndryshe nga sa pretendojnë mbrojtësit dhe e hetuara Margjeka, për të vazhdojnë të ekzistojnë dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale; (...) duke pasur parasysh

rëndësinë e fakteve dhe bashkëpunimin e secilit në kryerjen e veprave penale, ky kolegji vlerëson se duke mbajtur parasysh përshtatshmërinë e llojit të masës së sigurimit dhe shkaqet për të cilat gjykata e shkallës së parë e ndryshoi masën e sigurimit, vlerëson se masa e sigurimit sipas nenit 237 të KPP është më e përshtatshme për tu caktuar të hetuarës, pasi rrezikshmëria e veprave penale që i atribuohen janë të një shkalle të lartë dhe po kështu asnjë prej veprave penale nuk është shuar (...) fakti që në këtë moment është e domosdoshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore dhe në fazën në të cilën ndodhet hetimi, të bazuara në informacionin e dhënë nga prokurori, ka të dhëna të mjaftueshme për vijimin e masave të sigurimit, duke vlerësuar si të përshtatshme atë të caktuar në vendimin nr. 92, date 5.9.2020.

Nevojat e sigurimit për të hetuarën Margjeka nuk janë zbutur, dhe masa e sigurimit sipas nenit 234 të KPP nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit penal dhe as dënimit që mund të caktohet ndaj saj, persa kohë vazhdojnë hetimet për këtë çështje dhe ekziston rreziku që personi të bëjë përpjekje për të ndërhyrë tek dëshmitarët me qëllim që të ndryshojnë qëndrimin e tyre, ndaj vlerëson se më e përshtatshme është masa e sigurimit “arrest në shtëpi” (...) Në vlerësim të gjykatës, faktet e pretenduara nga mbrojtësit nuk hedhin poshtë provat e analizuara në informacionin e paraqitur nga akuza për këtë hetim. Mënyra dhe dinamika e zhvillimit të kësaj ngjarje ka çuar në zbulimin e identifikimin e disa prej të dyshuarve, që edhe u janë caktuar masat e sigurimit edhe pas vëzhgimit nga policia (...) prandaj gjykata krijon bindjen se lënia e lirë e secilit të dyshuar jo vetëm që pengon zbardhjen e plotë të rrethanave të kryerjes së kësaj veprë penale, por ekziston mundësia që të largohen dhe ti fshihet hetimit dhe gjykimit. (...) për Margjekën, fakti që ka një fëmijë të mitur dhe për arsye shëndetësore, me herët është mbajtur në konsideratë në caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në shtëpi’, ndaj ky kolegji nuk i konsideron të tilla që të çojnë në ndryshimin e masës së sigurimit. (...)”.

4. Kundër vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka paraqitur rekurs personi nën hetim Mimoza Margjeka, përfaqësuar nga av. Loren Liço, me të cilin kërkon: Ndryshimin e vendimit me nr. 221, datë 17.12.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, heqjen e masës së sigurimit dhe hetimin e saj në gjendje të lirë ose duke vendosur një masë më të butë siguri. Në rekurs parashtrihen këto shkaqe:

- Paraqesim rezerva persa i përket respektimit të neneve 221, 222, 22/a, 223 të KPP, në regjistrimin e përgjimit telefonik të komunikimit datë 07.07.2020, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. 186, datë 9.7.2020 dhe në bazë të nenit 151/1.3 të KPP, akti i përfituar nga ai përgjim është i papërdorshëm.

- Gjykatat kanë zbatuar gabim detyrimet ligjore të përcaktuara në nenet 248/2, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale.

- Nga përgjimet telefonike të z. Zhilla apo të Z.Cara, si dhe video përgjimet provohet se z.Cara nuk është në dijeni të bisedave të mëparshme ndërmjet av. S.Demiraj me shtetasit N.Bali për të bërë të mundur ndryshimin e masës së sigurimit për të vëllain e tij Orion Bali dhe ky i fundit pretendohet të ketë ndikuar, nëpërmjet shtetasit Klaudio Zhilla tek Arben Cara, bashkëshorti i gjyqtarës M.Margjeka. Është i vërtetë fakti që bashkëshortët Cara dhe Margjeka qëndrojnë në një apartament me qera të shtetasit Klaudio Zhilla, kjo është dhe lidhja mes Klaudio dhe Arben Carës, por takimi i tyre ka qenë tërësisht i rastësishëm dhe ai nuk ka qenë fare në dijeni të bisedave të mëparshme ndërmjet të hetuarve të tjerë.

- Gjykata e ka mbështetur dyshimin e arsyeshem për shtetasin Arben Cara vetëm në indicie, bile të marra në kundërshtim me ligjin, e jo në prova. Vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të ndryshohet pasi, bie në kundërshtim me KPP, me vendimit e KEDNJ, me vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Vetë organi i akuzës ka qenë dyshues për faktin penal të ndodhur. Gjykata e Apelit shprehet se: “Shtetasi Skënder Demiraj i ka dhënë shtetasit Arben Cara shumën 6000 Euro me qëllim zbutjen e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit Orjon Bali, periudhë pas të

cilës ka vijuar takimet me shtetasin Kludjo Zhilla, Arben Cara dhe Mimoza Margjeka". Në cilën provë e mbështet gjykata këtë fakt?!!

- Gjykata e Apelit ka rënduar padrejtësisht pozitën e të hetuarës M.Margjeka, duke e bërë fajtores para se provohet fajësia e saj (neni 4 i KPP) e si rrjedhojë, ka sjellë si pasojë heqjen e lirisë dhe vendosjen e masës së sigurimit "arrest në shtëpi" ndaj saj.

- Arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Apelit bie në kundërshtim me nenin 6/2 të KEDNJ-së, dhe praktikën e GJEDNJ-së, e cila në jurisprudencën e saj ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme mjaftueshmërinë e një justifikimi dhe arsyetimi të përshtatshëm, përse i përket paraburgimit apo arrestit në shtëpi; në një sërë rastesh konsiderohet i papërshtatshëm nëse është "abstrakt" ose "i bazuar në stereotipe"; Përse i përket rrezikut të largimit, GJEDNJ ka deklaruar se ai nuk mund të matet vetëm në bazë të dënimit të mundshëm që personi rrezikon, por duhet të vlerësohet duke ju referuar disa faktorëve të tjerë të rëndësishëm, si veçanërisht: karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjithë lidhjet e tij me Shtetin. (...) Arsyetimi i vendimit bie në kundërshtim me nenet 15/1, 27/1, 42/2 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 4 të KPP dhe praktikën e Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 7/2011 i Kolegjeve të Bashkuara të kësaj gjykate) dhe Gjykatës Kushtetuese.

- Në çështjen, objekt gjykimi, referuar dinamikës së veprimeve hetimore të realizuara nga organi procedues, rezulton se hetimet ndaj kësaj të hetuare nuk kanë si të vijnë më tej, pasi janë mbledhur të gjithë provat, përgjimet telefonike, vëzhgimet ambientale, provat shkresore të identitetit të tyre etj.

- Në vendim thuhet se ekziston rreziku i ikjes së personit nën hetim apo dhe rreziku i vazhdimësisë së veprimeve kriminale, por nuk arsyetohet se ku mbështetet ky arsyetim.

- Si e hetuara M.Margjeka dhe bashkëshorti i saj janë me nivel të lartë arsimor, njeri është me dy fakultete, psikologji dhe drejtësi, ndërsa tjetri me gradë "doktor i shkencave" dhe titull shkencor "profesor i asocuar", të dy në fushën e drejtësisë, të cilët kanë një femijë të mitur në moshën 3 vjeç, për të rritur, ndërkohë që M.Margjeka është pezulluar nga detyra. Në këto rrethana nuk ekziston rreziku i ikjes.

- Gjykata e Apelit ka qenë unanime në qëndrimin e saj për dy të hetuarit e tjerë O.Bali dhe A.Mullahi, ku është mbajtur i njëjti qëndrim, për të cilët janë të njëjtat prova dhe e njëjta akuzë, ndërsa për të hetuarën M.Margjeka është mbështetur në hetimin tendencioz dhe të pamotivuar të organit procedues, ndërkohë që sipas nenit 1 të KPP, nenit 15/1 të Kushtetutës së R.Shqipërisë, KEDNJ, si objektiv kushtetues është gjykimi i drejtë, i barabartë, i mbështetur në parimet e humanizmit, i mbrojtjes të të drejtave të ligjshme të shtetasve.

- Për këto arsye kërkojmë që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të ndryshojë vendimin e gjykatës së apelit pasi jemi në rastin që ndaj kësaj shtetase të mos vendoset asnjë mase sigurimi, por, edhe nëse çmohet vendosja e një mase sigurimi, kërkojmë të caktohet një masë tjetër sigurimi më e butë.

II.Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

5. Rekursi, nga personi nën hetim Mimoza Margjeka është nënshkruar nga mbrojtësi dhe është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale. Prokurori pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është njoftuar për rekursin.

6. Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i

ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndërsa pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

7. Kolegji risjell në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave (*të shqyrtuara nga gjykatat e faktit, mbi të cilat është vendosur për llojin e masës së sigurimit personal për personin nën hetim Mimoza Margjeka*) del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Pretendimet e parashtruara në rekurs lidhen me zbatimin e neneve 248/2, 229 dhe 230 të KPP, të cilat janë vlerësuar edhe më herët nga gjykatat në raport me ekzistencën e kushteve e kriterëve për caktimin e masave të sigurimi dhe provave të paraqitura nga akuza. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara, vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

8. Në tërësi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr. 221, datë 17.12.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të sipërpërmendura dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I:

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personi nën hetim Mimoza Margjeka, kundër vendimit nr. 221, datë 17.12.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 18.05.2021